



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 03.08.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01.08.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Ve - Mor" SH.P.K – Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës" – pjesa e II-te, me Nr. të Prok: 616-18-421-2-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të "Ve - Mor" SH.P.K – Pejë të dt. 01.08.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës" – pjesa e II-te, me Nr. 616-18-421-2-1-1 Nr. Brendshëm 616-18-015-2-1-1, kundër Njoftimit për tenderues të pasuksesshëm të AK –së, të datës 27.07.2018.
2. Vërtetohet vendimi i AK i njoftimit për dhënje të kontratës të publikuar me datë: 10.05.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit për tenderin "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës" – pjesa e II-te me Numër të prokurimit 616-18-421-2-1-1, Numër të Brendshëm 616-18-015-2-1-1, sipas Njoftimit për dhenje të kontratës me datën: 10.05.2018.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Ve - Mor" SH.P.K – Pejë me datë 01.08.2018, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja verore e rrugëve

dhe trotuareve ne qytetin e Prishtinës” – pjesa e II-te, me Nr. të Prok: 616-18-421-2-1-1; me Nr. te brendshem te prokurimit: 616-18-015-2-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 02.08.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Lidhur me piken 5 te kerkeses per rishqyrtim - Njoftimi mbi eliminimin e tenderuesve, gabimishte keni identifikuar se jeni eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit. Juve me daten 27.07.2018 ju eshte dorezuar letra standarde per tenderues te pasuksesshem qe do te thot se nuk jeni eliminuar por tenderi juaj nuk ka qen tender me çmimin me te ulet, ku ne Njoftimin per Kontrate dhe ne Dosjen e Tenderit kriter per dhenje te kontrates ka qen kriteri çmimi me i lir.

AK – komisioni i rivleresimit, ka bere vleresimin e ofertave gjithnje duke u mbeshtetur ne raportin e ekspertit dhe ne vendimin e panelit shqyrtues me numer te references 223/18.

AK ne baze te rekomandimeve nga ana e ekspertit ka kerkuar nga OE “Vemor” shpk informata shtese – referenca apo çertifikata te pranimeve per kontratat e realizuara per pune apo sherbime te ngjashme ne tre vitet e fundit. Pas pergjigjes nga ana e OE, AK oferten e OE “Vemor” shpk e ka cilesuar si te pergjegjshme.

Po ashtu AK ne baze te rekomandimit te ekspertit shqyrtues, ka ber kerkese per informata mbi tenderet jo normalishtë te ulet OE “TOIFOR” per te gjitha pozicionet e ofertes te cilat jan konsideruar si ab normalishte te uleta. Pas pergjigjes se OE, AK pergjigjet e OE i konsideron si te pranueshme per AK andaj edhe vendos qe per kontrate ta propozoi OE me çmimin me te lire te ofertes.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit